

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS– kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Vjollca Kurtishaj në çështjen penale kundër të akuzuarit Y.E. nga fshati ..., komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me ankesën e të dëmtuarit N.E., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.13142/2017 të datës 23.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 06.11.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të dëmtuarit N.E., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.13142/2017 të datës 23.07.2018, **vërtetohet**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin P.nr.13142/2017 të datës 23.07.2018, të akuzuarin Y.E., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK, për çka i ka shqiptuar vërejtje gjyqësore, me çka i ka bërë të njoftur të akuzuarit se vepra penale e kryer nga ai, është vepër e rrezikshme dhe e dënueshme dhe nëse i njëjti sërish kryen vepër të tillë penale, do të dënohet me dënim më të rëndë. I dëmtuari N.E. nga fshati nga fshati ..., komuna e Prizrenit, është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike. Shpenzimet e procedurës penale i janë vu në barrë të gjykatës, pasi që i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike, është i pa punë prandaj është liruar nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore sepse pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe familjes së tij.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i dëmtuari N.E., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.967/2018 me datë 09.10.2018, ka propozuar që ankesa e të dëmtuarit N.E., të aprovohet pjesërisht dhe atë vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin, ndërsa, në pjesën tjetër, të hudhet si e pa lejuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- ankesa nuk është e bazuar.

I dëmtuari me ankesë pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të karakterit absolut, sepse i njëjti nuk ka qenë i ftuar për seancën e datës 23.07.2018 .

I dëmtuari me ankesë ka theksuar se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse nuk janë administruar provat dhe askund nuk janë dëgjuar pretendimet e palëve.

I dëmtuari edhe pse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ankimon edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, e njëjta në ankesë nuk ka dhënë asnjë arsye lidhur me pretendimet e saja përkitazi me këto dy baza ankimore.

Kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se, sipas dispozitës së nenit 381 par. 3 të KPP “ i dëmtuari mund të ushtroj ankesë ndaj aktgjyimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurimit të trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale”.

Në rastin konkret vepra penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK, bën pjesë në Kapitullin XVI, në grupin e veprave penale kundër jetës dhe trupit, pra, bën pjesë në grupin e veprave penale ku të dëmtuarit i lejohet ankesa vetëm ndaj vendimit mbi dënimin, prandaj ankesa e të dëmtuarit përkitazi shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, hudhet si e pa lejuar.

I dëmtuari N.E., në ankesë ka theksuar se aktgjykimin e shkallës së parë e ankimon edhe për shkak të vendimit mbi dënimin mirëpo në ankesë nuk ka theksuar asnjë arsye lidhur me këtë bazë ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 të KPK-së, me ç’ rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar se i njëjti e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale, se ka treguar bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjelljen korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimin për kryerjen e veprës penale, faktin se deri më tani nuk ka qenë i dënuar, gjendjen e varfër ekonomike, se është i pa punë dhe i sëmurë kronik nga sëmundja kronike e zemrës ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtyllë të rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në fakt në ankesë nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Pra, duke marrë parasysh mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe rrethanat tjera, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjeneralë, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 400 e 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.961/2018 me datë 06.11.2018

Bashkëpunëtorja profesionale
Vjollca Kurtishaj

Kryetari i kolegjit-gjyqtari

1. Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

2. Shqipe Qerimi

3. Afrim Shala